

KIS Interpretimi 10

Ndihma Qeveritare - Pa Lidhje Specifike me Veprimtaritë e Shfrytëzimit

Referencat

- SNK 8 Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare
- SNK 20 Kontabiliteti për grantet qeveritare dhe dhënia e informacionit shtesë për ndihmën qeveritare

Çështja

- 1 Në disa vende ndihma qeveritare për njësitë ekonomike mund të ketë si qëllim inkurajimin ose mbështetjen afatgjatë për aktivitetet e biznesit në disa rajone ose sektorë të industrisë. Kushtet për të marrë një ndihmë të tillë mund të mos jenë të lidhura në mënyrë specifike me veprimtaritë e shfrytëzimit të njësisë ekonomike. Shembuj të kësaj ndihme janë transferimet e burimeve nga qeveria tek njësitë ekonomike të cilat:
 - (a) ushtrojnë aktivitetin në një industri të veçantë;
 - (b) vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin në industritë e privatizuara kohët e fundit; ose
 - (c) fillojnë ose vazhdojnë të bëjnë biznesin e tyre në sektorë të pazhvilluar.
- 2 Çështja shtrohet nëse kjo ndihmë qeveritare është një 'grant qeveritar' brenda objektit të SNK 20 dhe, si rrjedhim, duhet të trajtohet në përputhje me këtë standard.

Konsensusi

- 3 Ndihma qeveritare për njësitë ekonomike plotëson përkufizimin e granteve qeveritare në SNK 20, edhe nëse nuk ka kushte që lidhen në mënyrë specifike me veprimtaritë e shfrytëzimit të njësisë ekonomike, me përjashtim të kërkesës për të ushtruar aktivitetin në disa rajone ose sektorë të industrisë. Prandaj këto grante nuk do të kreditohen drejtpërdrejt në kapitalin neto.

Data e Konsensusit

janar 1998

Data e hyrjes në fuqi

Ky Interpretim hyn në fuqi më datën 1 gusht 1998. Ndryshimet në politikat kontabël do të bëhen në përputhje me SNK 8.